



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1305/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Bardha Dida Rugova, në cilësinë e Kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, Lëvizja Vetëvendosja (LVV) paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak se nuk e ka fituar mandatin për anëtare të kuvendit komunale, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2013, morri këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Bardha Dida Rugova, Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë nga Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 19.12.2013, nga Bardha Dida Rugova, Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, me të cilën pretendon se ka qenë e certifikuar nga KQZ-ja në cilësinë e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, ku pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe shpalljes së rezultateve zgjedhore që janë certifikuar nga KQZ-ja, i ka pas 303 vota, dhe nuk e ka fituar mandatin për anëtare të kuvendit komunal në Prishtinë. Më tutje ka shtuar se, bartësi i listës zgjedhore nga Iniciativa Qytetare Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe njëherit kandidat për kryetar të komunës së Prishtinës, duke pasur parasysh mospërputhjen në mes të ushtrimit të mandatit të kryetarit të Komunës dhe anëtarit të Kuvendit Komunal, i njëjti ka dhënë dorëheqje me dt. 16 dhjetor 2013, ku KQZ-ja ka bërë zëvendësimin e tij dhe dy kandidatëve të tjerë brenda listës së LVV-së, ku me rastin e zëvendësimit numri i votave sipas renditjes bazuar në numrin e votave parashtruesja e apelit thekson se gjendej në vendin e 11 (njëmbëdhjetë).

Sipas parashtrueses së apelit numri i votave nuk kishte qenë kriter gjatë zëvendësimit të saj dhe kështu që tre kandidatët të cilët ishin certifikuar si fitues të mandatit, ku dhe kishin dhënë dorëheqje, e në vend të tyre janë zëvendësuar tre burra nga lista e LVV-së, e që të tretë ishin me pak të votuar se unë thekson parashtruesja e apelit, ku të cilin veprim e konsideron si diskriminues dhe në kundërshtim me të drejtat themelore të njeriut.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i që të shqyrtoi ankesën dhe të nxjerrë vendim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet e Bardha Dida-Rugova, në cilësinë e Kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë nga LVV, se janë certifikuar tre burra për anëtarë të kuvendit komunal në Prishtinë nga lista e LVV-së edhe pse kishin më pak vota, sipas kandidates në fjalë ky veprim është diskriminues nuk qëndrojnë sepse bazuar në nenin 10.3 pika a e Ligjit për Zgjedhjet Lokale, i cili parasheh se KQZ-ja plotëson vendin e lirë nga kandidati i radhës i kualifikuar i të njëjtës gjini që gjendet në listën e ri renditur të kandidatëve të njëjtit subjekt politik.

Andaj bazuar në arsyet e cekura dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), i cili parasheh se; *PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat te cilat nuk i përmbushin standardet*, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1305/2013 më datën 23.12.2013.



Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.